



Pompa e nxehtësisë ajër/ujë • aroTHERM Split

Ndieni energjinë nga ajri



Vaillant Rehati për shtëpinë time



Pompa e nxehtësisë Vaillant: energji e pashtershme, teknologji e qëndrueshme e së ardhmes



"Jini inovativ, dëgjoni klientët", thoshte themeluesi i shoqërisë sonë Johann Vaillant që në vitin 1874. Kjo moto pa dyshim është ende e vlefshme.

Sot, kjo nënkupton përdorimin ideal të burimeve të rinovueshme të energjisë, ofrimin e një mënyre të zgjuar për kontrollimin e ngrohjes përmes një aplikacioni dhe duke u ofruar klientëve gjithçka që kanë nevojë për t'i bërë shtëpitë më komode, dhe të gjitha këto me cilësinë e garantuar nga një markë tradicionale gjermane.

Pompat tona të nxehtësisë janë shembulli më i mirë për këtë. Ato përdorin energjinë pafund të diellit që ndodhet në ajër, tokë dhe ujërat nëntokësore, si një burim falas të energjisë me zero emetime CO₂ dhe e kthejnë atë në komoditet më të madh të shtëpisë tuaj, në ngrohje gjatë dimrit, ftohje gjatë verës dhe në përgatitje së ujit të ngrohtë gjatë gjithë vitit.



Fatura më të ulëta në shtëpi

Krahasuar me sistemet konvencionale të kondensimit të gazit, pompa e nxehtësisë mund të reduktojë faturat e ngrohjes deri në 75%. Pompa e nxehtësisë përdor energjinë e mjedisit për të ngrohur dhe ftohur brendësinë e shtëpisë suaj.

Nga 100% të energjisë termike pompa e nxehtësisë përdor vetëm 25% të energjisë elektrike për të punuar. Pjesa e mbetur prej 75% është energjia termike falas nga mjedisit. Gjithashtu mund të prisni pavarësi 100% nga lëndët djegëse fosile, që gjithashtu do të thotë se nuk do të paguani fatura për analizimin e gazrave të tymit dhe pastrimin e oxhakut.

Më pak CO2 në mjedis

Sistemet tradicionale të ngrohjes përdorin lëndë djegëse fosile, gjë që i bën ato të shtrenjta dhe jo të qëndrueshme për mjedisin. Pompat e nxehtësisë konsumojnë më pak energji sesa sistemet tradicionale të ngrohjes, sepse përdorin burime të rinovueshme të energjisë dhe janë ekologjikisht më të pranueshme për shkak të efektit pozitiv në mjedis.

Zonë e gjerë e aplikimit



I përsosur për ndërtesat e reja

Pompat e nxehtësisë janë sisteme ngrohjeje me temperaturë të ulët. Kjo i bën të jenë ideale për objektet e reja që kanë kërkesa të ulëta energjetike falë izolimit të mirë. Shumica e energjisë përdoret për të ngrohur ujin, dhe në këtë aspekt pompat e nxehtësisë Vaillant mund të krenohen me vlerat më të mira dalëse që ju garantojnë komoditetin e përditshëm.

Të përshtatshme për objektet ekzistuese

Pompat e nxehtësisë gjithashtu mund të funksionojnë në mënyrë efektive në ndërtesat e vjetra - veçanërisht në rast të restaurimit me optimizim energjetik dhe të përdorimit të ngrohjes në dysheme në vend të radiatorëve. Rregull i përgjithshëm është se sa më i lartë të jetë niveli i modernizimit, aq më shumë rekomandohet përdorimi i pompave të nxehtësisë. Sistemi hibrid i pompës së nxehtësisë dhe i pajisjes kondensuese me gaz gjithashtu ofron besueshmëri më të madhe dhe efikasitet energjetik.

Pompat e nxehtësisë japin rezultate pavarësisht nga moti

Gjeografikisht, nuk ka kufizime se ku mund të përdoren pompat e nxehtësisë. Në mënyrë të besueshme dhe efektive nxehin edhe në veri, ku temperaturat bien deri në -20°C . Blerësit në rajonet jugore mund të jenë të interesuar në një tipar të integruar të ftohjes aktive, që mund të aktivizohet gjatë verës sipas konfigurimeve të përshtatshme.



Subvencionimet

Pompat e nxehtësisë me shumë kursim dhe efikasitet përdorin burimet e rinovueshme të energjisë. Për këtë arsye, pompat e nxehtësisë shpesh përfshihen në programet stimuluese kombëtare ose rajonale.



Eksperienca jonë është garancia juaj



Vaillant si një lider në teknologji ofron zgjidhje inovative të ngrohjes për më shumë se 145 vite. Ekspertizën tonë e kemi transferuar në zhvillimin e teknologjisë së pompave të nxehtësisë. Zgjidhjet tona, shumë prej të cilave janë të regjistruara me patentë, e kanë bërë këtë teknologji të besueshme, efikase dhe të përshtatshme për jetën e përditshme. Më shumë se 200 000 pompa nxehtësie të instaluar në mbarë botën e konfirmojnë këtë në praktikë çdo ditë. Shfrytëzoni përvojën tonë:

- Produkte të zhvilluara në Gjermani që prodhohen vetëm në BE.
- 100% testim i secilës pompë nxehtësie në linjën e prodhimit.
- Kushtet më ekstreme të motit simulohen në qendrat tona të testimit dhomat e ftohta ku temperatura ulet deri në -25°C.
- Pompat e nxehtësisë Vaillant janë ndër ato me më pak zhurmë në treg.
- Nivel i lartë i sigurisë falë përdorimit të standardeve të sigurisë.
- Administrim i cilësisë sipas normave EN ISO 9001 EN ISO 14001.



Çdo njësi testohet para se të dalë nga fabrika e prodhimit.



Një ekip me motivim të lartë prodhon pompat e nxehtësisë në fabrikën tonë në Nant.



Grupe të caktuara kryejnë teste në kushte ekstreme klimatike në dhoma të ftohta.



Të gjitha aplikimet e mundshme simulohen në një seri të gjerë testesh.



aroTHERM Split i ri: për komoditetin dhe kursimin tuaj



Pompa e nxehtësisë ajër-ujë aroTHERM Split, njësia hidraulike unitOWER



Moduli hidraulik i murit, rregullatori sensoCOMFORT, pompa e nxehtësisë ajër/ujë aroTHERM Split bojler i ujit të ngrohtë uniSTOR

aroTHERM Split është pompa e nxehtësisë që ofron raportin më të mirë midis investimit dhe përfitimit për ndërtesat rezidenciale. Përdor energjinë termike të ajrit si burim falas të energjisë. Sistemi aroTHERM Split është i përbërë nga dy pjesë - pompa e nxehtësisë e cila vendoset jashtë dhe njësia e brendshme.

Përparësitë për konsumatorin

Pompa e nxehtësisë vendoset pranë murit të shtëpisë ku nuk bie në sy, ose në një distancë deri në 25 metra në oborr. Njësia e brendshme unitOWER vendoset në shtëpinë tuaj. Njësia hidraulike me madhësi sa një frigorifer ju ofron një seri avantazhesh:

- kursim hapësire, instalim i padukshëm - të gjitha pjesët hidraulike janë tashmë të përfshira;
- komoditeti i përgatitjes së ujit të ngrohtë shtëpiak për katër persona falë rezervuarit të integruar me vëllim 190 litra.

Keni nevojë për më shumë ujë të ngrohtë? Atëherë thjesht kombinoni modulin hidraulik të murit me rezervuarin e ujit të ngrohtë uniSTOR:

- Vëllim deri 500 litra.
- Mund të përdoren njëkohësisht disa vende dalëse
- Komoditeti i lartë i përgatitjes së ujit të ngrohtë për deri gjashtë persona


- I mundshëm integrimi i sistemit diellor.

Vendosja sipas planit

aroTHERM Split mund të vendoset lehtë brenda një dite. Është një procedurë relativisht e thjeshtë dhe me kosto të pranueshme që nuk kërkon hapjen e vrimave të mëdha në mure.

Kompakte, por e fuqishme

88, 60, 69 (LxGJxTH në cm): me dimensionet e saj kompakte, unitOWER nuk zë shumë hapësirë të dobishme në shtëpitë e reja. E njëjta gjë vlen edhe për njësinë e jashtme të pompës së nxehtësisë.





Performancë e lartë, nivel i ulët i zhurmës

Zgjedhje e madhe modelesh e përshtatur për nevojat tuaja


Pompa e nxehtësisë aroTHERM Split është në dispozicion me fuqi të ndryshme dalëse nga 3 deri në 12 kW. Njëra prej tyre me siguri do t'ju përshtatet. Kombinojeni atë me njësinë tonë hidraulike uniTOWER dhe rregullatorin, dhe krijoni një sistem ngrohjeje shumë efikas:

Efikasiteti energjetik	aroTHERM, uniTOWER
Ngrohja	A+++ (G-A+++)
Uji i ngrohtë	A (F-A+)

Ekspertët dhe partnerët tanë do t'ju propozojnë sistemin e pompës të përshtatshëm për ju.

Do të bindeni: më pak zhurmë nuk është e mundshme

Sistemi aroTHERM nuk është vetëm jashtëzakonisht ekonomik dhe efikas: falë sistemit SoundSafeSystem është edhe jashtëzakonisht pa zhurmë. Niveli i zhurmës së modulit hidraulik nuk është më i lartë se ai i një frigoriferi modern. Njësia e jashtme gjithashtu punon jashtëzakonisht pa zhurmë. Zhurma e punës pothuajse nuk dëgjohet në distancë prej disa metrash dhe mund të krahasohet me shushurimën e gjetheve. Ky është një avantazh kyç, sidomos në zonat e banuara. Niveli i ulët i zhurmës mundëson që njësia e jashtme e pompës së nxehtësisë Vaillant të instalohet pa problem edhe në zonat urbane me kufizime strikte të zhurmës.



Vendosje fleksibël

Nuk keni nevojë për shumë hapësirë për të përfituar nga performancat e larta të pajisjes aroTHERM Split; në varësi të kërkesave tuaja, mund të vendoset në oborr, pranë murit të shtëpisë ose në çatinë e garazhit. Aksesorët për të gjitha llojet e instalimeve janë të disponueshme.



Zgjerim i sistemit për efikasitet edhe më të lartë

AroTHERM Split është një zgjidhje efikase dhe ekologjike për pranueshme për ngrohjen, ftohjen dhe përgatitjen e ujit të ngrohtë. Sistemin mund ta bëni edhe më efikas, më ekologjik dhe më praktik me zgjerimin e sistemit me pajisje shtesë. Pompat tona të nxehtësisë janë lojtarë të vërtetë ekipi. Ato adhurojnë të punojnë dhe komunikojnë në sistem, p.dh. me

- Me sistemin tonë të ventilimit të brendshëm të kontrolluar recoVAIR, në çdo kohë mund të shijohet ajër i pastër pa polen dhe me humbje minimale të nxehtësisë. Ky koncept gjithashtu ofron një zgjidhje gjithëpërfshirëse të ventilimit, që është e nevojshme në ndërtesat me izolim të mirë.

- Sistemi ynë solar auroTHERM mundëson përgatitjen e ujit të ngrohtë gjatë gjithë vitit. Zgjidhni nga një gamë e gjerë e rezervuarëve për ujë të ngrohtë me nxehtësi indirekte dhe përdorni energjinë diellore për një mënyrë shumë efikase dhe të qëndrueshme të ngrohjes së ujit.

- Sistemi ynë fotovoltaik auroPOWER ju mundëson krijimin e energjisë suaj elektrike të nevojshme për funksionimin e pompës së nxehtësisë aroTHERM Split.

ventilimin e hapësirës së banimit ose me sistemet fotovoltaike. Nëse dëshironi të përdorni edhe më shumë burime të rinovueshme të energjisë - s'ka problem. Të gjitha pajisjet Vaillant mund të instalohen lehtë dhe të integrohen në sistem. Sipas dëshirës sistemet mund të avancohen. Falë ndërfaqes eBUS, çdo gjë mund të vendoset dhe të rregullohet lehtë.



Sistem ventilimi për shtëpi recoVAIR



Rezervuari solar auroSTOR, kolektori solar auroTHERM



Sistemet fotovoltaike auroPOWER






- 1 Pompat e nxehtësisë aroTHERM Split
- 2 Njësia hidraulike uniTOWER
- 3 Ngrohje në dysheme

- 4 Sistemi i mesëm i ventilimit recoVAIR
- 5 Modulet fotovoltaike auroPOWER
- 6 Inverteri auroPOWER

- 7 Bateria
- 8 Rregullimi sensoCOMFORT

Të dhënat teknike

Të dhënat	Njësia	aroTHERM Split						
		VWL 35/5 AS 230V	VWL 55/5 AS 230V	VWL 75/5 AS 230V	VWL 105/5 AS 230V	VWL 105/5 AS 400V	VWL 125/5 AS 230V	VWL 125/5 AS 400V
Në kombinim me uniTOWER-in		VWL 58/5 IS		VWL 78/5 IS	VWL 128/5 IS			
Klasi i efikasitetit energjetik në ngrohje 35 °C (A+++ do G)		A+++	A+++	A++	A+++	A+++	A+++	A+++
Klasi i efikasitetit energjetik në përgatitjen e UNSH-së (A+ deri në F)		A	A	A	A	A	A	A
Në kombinim me modulën		VWL 57/5 IS		VWL 75/5 IS	VWL 127/5 IS			
Klasi i efikasitetit energjetik në ngrohje 35°C / 55°C (A+++ do G)		A+++ / A++	A+++ / A++	A++ / A++	A+++ / A++	A+++ / A++	A+++ / A++	A+++ / A++
Informacion për lëndën ftohëse								
Distanca min / maks. midis njësive së jashtme dhe asaj të brendshme (njësia e brendshme mbi atë të jashtme)	m	3 - 25						
Diferenca e lejuar në lartësi midis njësive së jashtme dhe asaj të brendshme (njësia e brendshme mbi atë të jashtme)	m	10						
Distanca min / maks. midis njësive së jashtme dhe asaj të brendshme (njësia e jashtme mbi njësinë e brendshme)	m	3 - 40						
Diferenca e lejuar në lartësi midis njësive së jashtme dhe asaj të brendshme (njësia e jashtme mbi njësinë e brendshme)	m	30						
Lënda ftohëse, lloji		R410A						
Lënda ftohëse, sasia mbushëse	kg	1,50	2,39	3,60				
Potenciali i ngrohjes globale sipas Rregullores BE nr. 517/2014	GWP	2088						
Ekuivalent CO ₂	t	3,13	4,99	7,52				
Diametri i tubit të gazit / lëngut	"	1/2 dhe 1/4		5/8 dhe 3/8				
Limitet e përdorimit, nxehja e ngrohjes								
Temp. min./maks. e ajrit	°C	-20/20						
Limitet e përdorimit, përgatitja e UNSH								
Temp. e ajrit tek UNSH min./ maks.	°C	-20/43						
Limitet e përdorimit, impianti i ftohjes								
Temp. min./maks. e ajrit	°C	15/46						
Efekti në impiantin e ngrohjes								
Efekti i ngrohjes/konsumi i energjisë elektrike/COP tek A2/W35, EN 14511	kW	2,46/0,66/3,75	3,37/0,92/3,67	4,51/1,23/3,68	8,20/2,12/3,87	8,20/2,12/3,87	8,23/2,26/3,64	8,23/2,26/3,64
Efekti i ngrohjes/konsumi i energjisë elektrike/COP tek A7/W35, EN 14511	kW	3,13/0,64/4,89	4,42/0,95/4,68	5,78/1,23/4,58	9,70/2,12/4,57	9,70/2,12/4,57	10,25/2,26/4,54	10,25/2,26/4,54
Efekti i ngrohjes/konsumi i energjisë elektrike/COP tek A7/W45, EN 14511	kW	3,05/0,86/3,54	4,04/1,16/3,49	5,47/1,53/3,57	9,06/2,60/3,49	9,06/2,60/3,49	9,60/2,75/3,49	9,60/2,75/3,49
Temperatura maksimale e rrjedhës nisëse të ngrohjes (pa ngrohëse elektrike)	°C	55						
Temperatura maksimale e përgatitjes së UNSH-së (me ngrohëse elektrike)	°C	63 (75)						
Efekti në impiantin e ftohjes								
Efekti ftohës/Konsumi i energjisë elektrike/EER tek EN 14511, A35/W18	kW	4,83/1,29/3,76	4,83/1,29/3,76	6,30/1,76/3,58	12,78/3,90/3,28	12,78/3,90/3,28	12,78/3,90/3,28	12,78/3,90/3,28



Informacione të përgjithshme								
Dimensionet LxGxTH	mm	765x1100x450	765x1100x450	965x1100x450	1565/1100/450	1565/1100/450	1565/1100/450	1565/1100/450
Pesha pa paketimin	kg	82	82	113	191	191	191	191
Tensioni i lidhjes	V/Hz	230 (+10%/-15%) / 50 Hz 1~/N/PE				400 (+10%/-15%) / 50 Hz 1~/N/PE	230 (+10%/-15%) / 50 Hz 1~/N/PE	400 (+10%/-15%) / 50 Hz 1~/N/PE
Rryma startuese	A	11,5	11,5	14,9	21,3	13,5	21,3	13,5
Niveli i mbrojtjes		IP15B						

Fuqia e zhurmës në impiantin e ngrohjes								
Fuqia e zhurmës, En 12102, EN ISO 9614-1, A7/W35	dB(A)	51	53	54	58	58	59	58
Fuqia e zhurmës, En 12102, EN ISO 9614-1, A7/W45	dB(A)	51	53	55	59	58	59	59
Fuqia e zhurmës, En 12102, EN ISO 9614-1, A7/W55	dB(A)	53	54	54	60	60	60	60

Fuqia e zhurmës në impiantin e ftohjes								
Fuqia e zhurmës, En 12102, EN ISO 9614-1, A35/W18	dB(A)	54	54	56	59	59	59	59
Fuqia e zhurmës, En 12102, EN ISO 9614-1, A35/W7	dB(A)	54	54	55	58	59	58	59

Të dhënat teknike		uniTOWER		
		VWL 58/5 IS	VWL 78/5 IS	VWL 128/5 IS
Dimensionet LxGxTH	mm	1880x595x693		
Pesha pa paketimin	kg	158	158	158
Pesha gati për punë	kg	365	365	365
Tensioni i dimensionuar	V/Hz	230 V (+10%/-15%), 50 Hz 1~/N/PE		
Tensioni i dimensionuar	V/Hz	400 V (+10%/-15%), 50 Hz 3~/N/PE		
Niveli i mbrojtjes		IP 10B		
Vëllimi i rezervuarit	l	188		
Efekti i ngrohëses elektrike	kW	5,4	5,4	8,5
Rrjedha nisëse/kthyese	l	G1		
Prerja e tubit faza e gazit	"	1/2	5/8	5/8
Prerja e tubit faza rrjedhëse	"	1/4	3/8	3/8
Ngrohja rrjedha dërgim/kthim		G 1		
Lidhja uji i ngrohtë/i ftohtë		G 3/4		
Priza riqarkullimi		G 3/4		

Të dhënat teknike		Moduli hidraulik		
		VWL 57/5 IS	VWL 77/5 IS	VWL 127/5 IS
Dimensionet LxGxTH	mm	720x440x350		
Pesha pa paketimin	kg	23	24	26,5
Tensioni i dimensionuar	V/Hz	230 V (+10%/-15%), 50 Hz 1~/N/PE		
Tensioni i dimensionuar	V/Hz	400 V (+10%/-15%), 50 Hz 3~/N/PE		
Efekti i ngrohëses elektrike	kW	5,4	5,4	8,5
Niveli i mbrojtjes		IP 10B		
Rrjedha nisëse/kthyese		G1		
Prerja e tubit faza e gazit	"	1/2	5/8	5/8
Prerja e tubit faza rrjedhëse	"	1/4	3/8	3/8
Ngrohja rrjedha dërgim/kthim		G 1		
Lidhja uji i ngrohtë/i ftohtë		G 1		



EU Ecolabel:
2011/333/EC